

BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE
TË BANKËS SË SHQIPËRISË
Korrik - Dhjetor 2023



LAJME DHE
NGJARJE
NË 6 MUAJ

Nr. 14





Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko.

EDITORIAL

Të nderuar Lexues,

Me kënaqësi ju paraqesim numrin e ri të Revistës "Bankingu Qendror: lajme dhe ngjarje në gjashtë muaj" për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2023. Ky numër sjell në vëmendjen tuaj veprimtaritë e realizuara gjatë periudhës, duke pasqyruar përpjekjet dhe hapat e ndërmarrë për të përmbushur objektivat tanë më të rëndësishëm, me fokus në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e përgjithshme të vendit.

Banka e Shqipërisë vlerëson përfshirjen financiare dhe edukimin financiar, si dy objektiva strategjike mjaft të rëndësishëm për stabilitetin monetar e financiar të vendit, formalizimin e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Në këtë kuadër, ajo ka ndërmarrë një sërë nismash të rëndësishme, një ndër të cilat është dhe miratimi i ligjit "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".

Ky ligj synon të ofrojë shërbimet e pagesave për të gjithë konsumatorët dhe veçanërisht për individët që nuk zotërojnë llogari bankare, pa kosto ose me kosto të përballueshme prej tyre, duke garantuar dhe mundësuar të drejtën e çdo konsumatori - pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit apo historikut të aftësisë paguese - për të pasur akses në shërbimet bazë të llogarisë së pagesës.

Më konkretisht, parashikohet që për disa kategori vulnerabël, të tilla si pensionistët, jetimët, invalidët e punës, personat me ndihmë sociale dhe ekonomike etj., ofrimi i shërbimeve do të jetë pa kosto, ndërsa për pjesën tjetër të konsumatorëve kostoja do të jetë më e ulët krahasuar me shërbimet e tjera të një llogarie pagesash të formës standarde.

Konsumatorëve që nuk posedojnë llogari të tjera, u lind e drejta që, me kërkesë të tyre, të pajisen me një llogari pagese me shërbime bazike. Ndërsa ata që aktualisht posedojnë llogari të tjera, me kërkesë të tyre, mund të pajisen me një llogari pagese me shërbime bazike, duke konvertuar një llogari ekzistuese në një llogari pagesash me shërbime bazike ose duke hapur një llogari të re e duke mbyllur atë ekzistuese.

Miratimi i këtij ligji përmbush detyrimet e Bankës së Shqipërisë në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023) dhe të procesit të integritimit evropian, duke treguar dhe njëherë se veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është orientuar gjithmonë nga jetësimi i angazhimeve të ndërmarra dhe vizionit për një të ardhme të përbashkët evropiane.

Një llogari bankare është një mjet thelbësor i pjesëmarrjes në shoqërinë moderne. Pa një të tillë, është e vështirë të punojmë, të bëjmë pagesa apo të paguajmë faturat e shërbimeve.

Prandaj, ky ligj përbën një nga hapat më të rëndësishëm në drejtim të garantimit të aksesit në shërbimet bankare për pjesën më të madhe të popullsisë. Zbatimi i tij pritet të shënojë padyshim një arritje në afrimin e personave drejt bankave, për ta shndërruar në vijim në një mision më angazhues, përdorimin e këtyre llogarive aktive për më shumë veprime jo me para fizike, për më shumë transferta elektronike e remitanca që më parë mund të merreshin e dërgoheshin në formën e parasë fizike.

GUVERNATORI SEJKO NË CEREMONINË E LISTIMIT TË TITULLIT TË PARË JOQEVERITAR NË BURSË 5 korrik 2023, Tiranë

Në datën 5 korrik 2023, Guvernatori Sejko mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE) me rastin e listimit të titullit të parë joqeveritar në bursë.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Guvernatori Sejko theksoi rëndësinë e listimit të titullit të parë joqeveritar në bursë, i cili vjen si rezultat i një punë dhjetëvjeçare të disa institucioneve si: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë, si dhe falë ideatorëve të ndërtimit të një burse shqiptare të titujve, aksionarëve të saj, Bankës Credins, Bankës Amerikane të Investimeve dhe AK-Invest.

Në krye të fjalës së tij, Guvernatori Sejko

vuri në dukje përfitimet që ka ekonomia nga zhvillimi i tregut të kapitalit si: përmirësimi i financimeve afatgjata të kompanive; ndikimi në uljen e ekspozimit të vendit ndaj ndërprerjes së papritur të kapitalit të huaj; përfitimit të asistencës në drejtim të thellimit të tregut financiar dhe rritjes së efikasitetit të shpërndarjes së kapitalit në ekonomi. Paralelisht, nëpërmjet investimeve të jorezidentëve, ajo ndihmon në sigurimin e likuiditetit si dhe në shpërndarjen gjeografike të rrezikut; përmirëson më tej stabilitetin financiar të vendit, ndikon në rritjen e shkallës së formalizimit të ekonomisë, në rritjen e transparencës financiare të bizneseve si dhe përmirësimin imazhin e tyre; rrit shkallën e mbikëqyrjes së tregut, si dhe përmirëson praktikën e mirëqeverisjes së vetë kompanive të listuara.

Më tej, Guvernatori Sejko u ndal edhe në masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për tregtimin dhe regjistrimin elektronik të shkëmbimit të titujve. Në këtë kontekst, ai





GUVERNATORI SEJKO PREZANTON RAPORTIN VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2022 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

6 korrik 2023, Tiranë

përmendi punën e bërë për përmirësimin e sistemeve të pagesave dhe krijimin e institucioneve depozitare, përfshirë këtu edhe ato private. Gjithashtu, ndër të tjera, Guvernatori Sejko përmendi punën e Bankës së Shqipërisë në drejtim të nxitjes së tregut sekondar të titujve qeveritarë për ta shndërruar atë në një treg më likuid, të aftë për të amortizuar ndikimin e goditjeve të primit të rrezikut të likuiditetit.

Në datën 6 korrik 2023, Guvernatori Sejko prezantoi Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2022 përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë është detyrim ligjor, nëpërmjet të cilit përmbushet procesi llogaridhënës dhe detyrimi i transparencës së institucionit për punën dhe rezultatet gjatë harkut kohor të një viti.

Guvernatori Sejko e nisi fjalën e tij duke theksuar se ekonomia shqiptare ka qenë subjekt i goditjeve të shpeshta, komplekse





e të paprecedenta, gjatë viteve të fundit. Ai u shpreh se pas tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë së viteve 2020-2021, gjatë vitit 2022, u përballëm me pasojat ekonomike dhe financiare të shkaktuara nga agresioni ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës. Më tej, ai u shpreh se realiteti i ri ekonomik dhe gjeopolitik testoi qëndrueshmërinë e ekuilibrave ekonomike e financiarë të vendit, ofroi sfida serioze për bizneset dhe familjet shqiptare, si dhe kërkoi reagimin e shpejtë dhe të koordinuar të autoriteteve publike.

Ai theksoi se rezistenca e admirueshme e ekonomisë shqiptare përballë krizave të viteve të fundit është dëshmi, në radhë të parë, e dinamizmit, fleksibilitetit dhe bilanceve të shëndosha të bizneseve dhe familjeve shqiptare. Paralelisht me to, ajo pasqyron edhe reagimin e duhur të politikave monetare, financiare e fiskale, si dhe frytet e reformave të vazhdueshme strukturore që kemi ndërmarrë në sektorin real e financiar të ekonomisë.

Guvernatori më tej u shpreh se aktiviteti i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2022 është orientuar

nga përmbushja e misionit dhe detyrave ligjore, nga jetësimi i angazhimeve të ndërmarra në strategjinë afatmesme të zhvillimit, si dhe nga respektimi i rekomandimeve të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022. Ai theksoi se Banka e Shqipërisë do të vijojë me të njëjtën filozofi të udhëheqë punën edhe përgjatë vitit 2023 e në vazhdim.

TRYEZË DISKUTIMI E BANKËS SË SHQIPËRISË ME SISTEMIN BANKAR DHE SHOQATËN SHQIPTARE TË BANKAVE

13 korrik 2023, Tiranë

Në datën 13 korrik 2023, në ambientet e Bankës Shqipërisë, u mbajt një tryezë diskutimi midis Bankës së Shqipërisë, Bordit Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe



drejtuesve të bankave tregtare që operojnë në vendin tonë. Takimi u organizua me nismën dhe nën drejtimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në kuadër të ndërtimit të një dialogu të vazhdueshëm me sistemin bankar, si dhe të intensifikimit të bashkëpunimit për çështje aktuale me rëndësi të veçantë.



Gjatë takimit u prezantua vlerësimi i Bankës së Shqipërisë për situatën financiare në vend, zhvillimet e kësaj periudhe dhe sfidat e së ardhmes. Shëndeti financiar i ekonomisë shqiptare është i konsiderueshëm, falë përmirësimeve të vazhdueshme në sektorin e jashtëm, vënies nën kontroll të borxhit publik dhe fleksibilitetit operacional, si dhe bilanceve të shëndosha të biznesit shqiptar. Po ashtu, sektori bankar paraqitet me bilance të shëndetshme dhe një shkallë të lartë rezistence ndaj goditjeve të mundshme.

Në përfundim, Shoqata Shqiptare e Bankave falenderoi Bankën e Shqipërisë për këtë takim mjaft pozitiv dhe frytdhënës, duke e

përhëndetur veçanërisht për mbështetjen e ofruar ndaj sistemit bankar gjatë kësaj periudhe sfiduese. Të dyja palët shprehën angazhimin e plotë për vijimin e bashkëpunimit të ndërsjellët institucional, si dhe, me autoritetet qendrore dhe vendore, në funksion të një sektori bankar sa më të shëndetshëm dhe mbështetës të zhvillimit ekonomik të vendit.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E 9-TË TË BQE-SË PËR VENDET E EQJLJ-SË

17 korrik 2023, Frankfurt, Gjermani

Në datën 17 korrik 2023, Guvernatori Sejko mori pjesë në konferencën e 9-të për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (EQJLJ), me temë "Ndryshimi i mjedisit gjeopolitik – ndikimet ekonomike për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore", organizuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE), në Frankfurt, Gjermani.



Kjo konferencë është një forum në të cilin diskutohen problemet kryesore ekonomike dhe financiare në rajon, duke ofruar një platformë për të thelluar të kuptuarin e ekonomive të vendeve të EQJLJ-së, si dhe për të shkëmbyer pikëpamje mbi çështjet e politikave.



Guvernatori Sejko ishte pjesë e panelit të sesionit me temë “Një këndvështrim më afatgjatë – ndryshime të mundshme strukturore në të ardhmen”, nën drejtimin e z. Frank Elderson, Anëtar i Bordit Ekzekutiv, BQE.



Guvernatori theksoi se procesi i integritimit evropian përbën një objektivi strategjik afatgjatë. “Ky proces është një shtytës i fortë për reformat strukturore, për konvergimin e plotë me standardet e BE-së të institucioneve vendase, si dhe për përfarimin e përgjithshëm të politikave dhe rregulloreve. Të gjitha këto veprime do të përmirësojnë thellësisht klimën

e biznesit, do të tërheqin investime të huaja dhe do të rrisin produktivitetin e përgjithshëm të ekonomisë sonë.”- tha Guvernatori.

GUVERNATORI SEJKO ME PËRFAQËSUESIN E RI REZIDENT RAJONAL PËR BALLKANIN PERËNDIMOR TË FMN-SË

7 shtator 2023, Tiranë

Në datën 7 shtator 2023, Guvernatori Sejko dhe përfaqësuesi i tjerë të BSH-së zhvilluan një takim pune me një delegacion të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i Përfaqësuesit të ri Rezident Rajonal për Ballkanin Perëndimor të FMN-së, z. Sebastian Sosa, i cili do të zëvendësojë në këtë detyrë zj. Stephanie Eble, e cila përfundoi me sukses mandatin e saj. Z. Sosa është një ekonomist me përvojë, i cili ka punuar në një sërë detyrash në vende dhe rajone të ndryshme si: Maqedonia e Veriut, Serbia, Spanja, Kili, Meksika, Bolivia, Uruguai dhe Libani.



Fillimisht, Guvernatori Sejko i drejtoi një falënderim të veçantë zj. Stephanie Eble për kontributin e dhënë gjatë këtyre viteve, si dhe angazhimin e saj në asistencat e ndryshme teknike të ofruara për Bankën e Shqipërisë,

kryesisht në fushat e politikës monetare, statistikave dhe mbikëqyrjes bankare.

Ndërkohë, zj. Stephanie Eble vlerësoi punën dhe rezultatet e arritura nga Banka e Shqipërisë në drejtim të forcimit të stabilitetit monetar e financiar të vendit. Në veçanti, zj. Eble u ndal te rëndësia e kthimit të inflacionit në objektiv dhe shprehu mbështetjen ndaj masave të Bankës së Shqipërisë për të vijuar me normalizimin e politikës monetare.



Më tej, ata inkurajuan Bankën e Shqipërisë të vijojë monitorimin e vazhdueshëm të situatës, si dhe koordinimin e politikave me autoritetet shqiptare, duke marrë masat e nevojshme në kohën e duhur.

GUVERNATORI SEJKO NË TAKIM ME MINISTRIN E FINANCAVE DHE EKONOMISË

22 shtator 2023, Tiranë

Në datën 22 shtator 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me Ministrin e ri të Financave dhe Ekonomisë, z. Ervin Mete, ku diskutuan mbi situatën aktuale ekonomike të vendit, pritshmëritë dhe zhvillimet më të fundit ekonomike. Në krye të takimit, Guvernatori Sejko e uroi Ministrin Mete për emërimin e tij në detyrën e re si Ministër në krye të një

institucioni kyç në zhvillimin e mëtejshëm të vendit.



Në vijim, Guvernatori u shpreh se nga këndvështrimi makroekonomik zhvillimet ekonomike kanë qenë pozitive, ekonomia është zgjeruar me ritme të mira, inflacioni ka shënuar rënie progresive, aktiviteti ekonomik, punësimi e pagat kanë vijuar të rriten, ndërsa ekuilibrat e përgjithshëm ekonomikë dhe financiarë të vendit kanë ardhur në përmirësim. Më tej, Guvernatori shtoi se parashikimet e Bankës sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë viteve në vijim, ndërsa inflacioni do të kthehet në objektivin e politikës së saj monetare prej 3% gjatë vitit të ardhshëm.



Dy titullarët ndanë të njëjtin opinion se politika monetare dhe ajo fiskale duhet të jenë të koordinuara dhe të orientohen drejt ruajtjes së ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit. Diskutimet u fokusuan edhe në ecurinë e kursit të këmbimit, rritjen e kreditimit në vend, dhe projektet e përbashkëta në modernizimin e mëtejshëm të sistemeve të pagesave etj.

Në përfundim, të dy palët u shprehën të gatshëm të vazhdojnë bashkëpunimin, si dhe të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe ruajtje stabilitetin financiar në vend.



GUVERNATORI SEJKO NË FORUMIN E MINISTRAVE TË EKONOMISË "TREGU I PËRBASHKËT RAJONAL – NJË HAP DREJT TREGUT UNIK TË BE-SË"

26 shtator 2023, Tiranë

Në datën 26 shtator 2023, Guvernatori Sejko ishte i ftuar të merrte pjesë në Ministerialin e ministrave të ekonomisë të vendeve të rajonit, të mbajtur në Tiranë, në kuadër të procesit të Berlinit. Guvernatori Sejko ishte pjesë e

Panelit të Guvernatorëve në sesionin e tretë, me temë "Integrimi i sistemeve të pagesave të rajonit për të lehtësuar tregtinë dhe përgatitjen e ekonomive të Ballkanit Perëndimor për integrimin në Eurozonë". Gjatë fjalës së tij, Guvernatori u ndal në rëndësinë e zhvillimit të sistemeve të pagesave në kuadër të zhvillimit ekonomik dhe formalizimit të ekonomisë në kontekstin vendas, në veçanti kontributi që pagesat e shpejta japin në përfshirjen financiare, çarkullimin e parasë në kanale formale, rritjen e konkurrencës, reduktimin e tarifave për pagesat elektronike etj.





Më tej, ai veçoi rëndësinë e projektit rajonal për “Modernizimin e sistemit të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor”, i cili mbështet zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal dhe Planit Ekonomik të Investimeve për Ballkanin Perëndimor të bazuar në rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian, me synimin për të rritur atraktivitetin dhe konkurrencën e rajonit dhe për ta afruar atë me tregjet e BE-së.

Guvernatori Sejko shtoi se Komisioni Evropian ka miratuar gjithashtu edhe një Plan gjithëpërfshirës Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili synon të nxisë rimëkëmbjen ekonomike afatgjatë të rajonit, të mbështesë kalimin në një ekonomi të gjelbër dhe transformimin digjital, si dhe të forcojë integrimin dhe konvergjencën rajonale me Bashkimin Evropian.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN “SFIDAT DHE PERSPEKTIVA E BASHKËPUNIMIT EKONOMIK KOSOVË- SHQIPËRI DHE RAJON” 5-6 tetor 2023, Prishtinë, Kosovë

Në datat 5-6 tetor 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një vizitë pune dyditore në Prishtinë, ku mori pjesë në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë “Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon”, të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë, dhe kreu një vizitë zyrtare në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Ditën e parë të kësaj vizite, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me Guvernatorin e ri të



Ditën e dytë të kësaj vizite, Guvernatori mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare, të organizuar nga akademitë e dy vendeve, për të diskutuar mbi prospektet dhe sfidat e zhvillimit monetar dhe financiar të Shqipërisë dhe Kosovës. I ftuar si folës në panelin e parë, Guvernatori Sejko diskutoi lidhur me temën "Prospektet dhe sfidat e zhvillimit monetar e financiar dhe integritimit ekonomik për bashkëpunimin ekonomik Kosovë-Shqipëri në kuadrin e integritimit rajonal".

Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, z. Ahmet Ismaili, në ambientet e BQK-së. Ai e uroi Guvernatorin Ismaili për detyrën e re, duke i rikonfirmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e Bankës së Shqipërisë. Guvernatori Sejko dhe Guvernatori Ismaili dakordësuan se lidhjet midis dy institucioneve do të vijojnë të jenë të qëndrueshme dhe të frytshme dhe se bashkëpunimi do të zgjerohet më tej në sektorin financiar, duke përfshirë gjithashtu aktivitete të përbashkëta në kuadër të edukimit financiar.



Guvernatori u shpreh se ekonomitë e dy vendeve kanë strukturë relativisht të ngjashme të organizimit të sektorit privat, si dhe të sistemeve financiare përsa i përket natyrës dhe fazës së zhvillimit të tyre të dominuara kryesisht nga bankat, të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve. Ndërkohë, sfidat kryesore për të dyja ekonomitë kanë qenë dhe mbeten produktiviteti dhe konkurrueshmëria, si dhe madhësia e vogël krahasuar me Eurozonën.

ZËVENDËSGUVERNATORJA AHMETAJ PËRSHËNDET PREZANTIMIN E RAPORTIT TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR 10 tetor 2023, Tiranë

Më 10 tetor 2023, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u prezantua Raporti i Perspektivës Ekonomike Botërore i Fondit Monetar Ndërkombëtar, tetor 2023. Ky raport prezanton zhvillimet ekonomike globale në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, sipas analizave të ekonomistëve të FMN-së. Në fokus ishte inflacioni dhe politika monetare, kërkimet dhe vlerësimet më të fundit të FMN-së, lidhur me rolin që ka luajtur procesi i formimit të pritjeve në mjedisin aktual me inflacion të lartë dhe ndikimin e tij në politikën monetare. Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, mbajti një fjalë përshëndetëse për të pranishmit, ku u shpreh se me rritjen e shpejtë të çmimeve, pothuajse të gjitha bankat qendrore kryesore nisën një kurs të shpejtë normalizimi të politikës monetare për të luftuar inflacionin, në mënyrë që të shmangnin një gërryerje të fuqisë blerëse të individëve dhe paqëndrueshmërinë



monetare dhe financiare. Ajo theksoi se normat e interesit në bankat qendrore me rëndësi sistemike janë ato që drejtojnë kryesisht tendencat e politikës monetare botërore.

Lidhur me vendin tonë, zj. Ahmetaj shtoi se përgjigjja e menjëhershme e politikës monetare po tregon tashmë shenja



premtuese, të paktën në drejtim të frenimit të inflacionit, duke e vënë atë në një trajektore rënëse. Gjithashtu, zj. Ahmetaj theksoi se besueshmëria e një banke qendrore është pasuria e saj më e madhe. Si e tillë, ajo duhet të ushqehet me kujdes, si në kohë të mira ashtu edhe të këqija, nëpërmjet veprimeve politike koherente dhe të qëndrueshme dhe një komunikimi transparent.

GUVERNATORI SEJKO NË MBLEDHJET VJETORE TË FMN DHE BB 12-15 tetor 2023, Marrakesh, Marok

Në datat 12 -15 tetor 2023, Guvernatori Sejko, mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), të cilat u zhvilluan në Marrakesh, Mbretëria e Marokut. Këto mbledhje përfaqësojnë një forum të nivelit të lartë, ku vendimmarrësit e FMN-së dhe BB-së, së bashku me guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare në këto institucione ndërkombëtare financiare, mbledhen së bashku për të diskutuar zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore.



Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këto takime me një delegacion të kryesuar nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, si dhe drejtues të tjerë të lartë. Gjatë takimeve me përfaqësuesit e FMN-së dhe BB-së, Guvernatori Sejko i njohu të pranishmit me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare. Ai u shpreh se Shqipëria, ashtu si edhe vendet e tjera, u prek nga goditjet e pafavorshme ekonomike globale. Inflacioni në Shqipëri filloi të rritet në fund të vitit 2021, u përshpejtua me shpërthimin e agresionit të Rusisë në Ukrainë, arriti kulmin në tetor 2022 dhe filloi të ngadalësohej gradualisht më pas.

Guvernatori shtoi se Banka e Shqipërisë për të garantuar stabilitetin monetar dhe financiar të vendit, nisi procesin e normalizimit të qëndrimit të politikës monetare, duke filluar nga marsi i vitit 2022. Ky normalizim u realizua nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit, nga minimumi prej 0.50% në fillim të vitit 2022, në nivelin 3.00% në mars 2023.





Në këtë kuadër, Guvernatori Sejko theksoi se politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka qenë e mbështetur plotësisht në të dhëna transparente dhe i është komunikuar në mënyrë efektive aktorëve vendas. Ai shtoi se aktualisht, norma bazë e interesit në vend është e ulët krahasuar me vendet e rajonit dhe ato të BE-së, duke reflektuar një normë më të ulët inflacioni të përgjithshëm. Ndërkohë, parashikimet tregojnë për një reduktim gradual të tij, me një kthim në objektivin tonë prej 3% që pritet të arrihet në mesin e vitit 2024.



Nga ana tjetër, përfaqësuesit e FMN-së dhe BB-së e vlerësuan pozitivisht rolin dhe politikën e ndjekur nga Banka e Shqipërisë, duke u ndalur në veçanti te rëndësia e kthimit të inflacionit në objektiv dhe avantazhet që jep fortësia e monedhës vendase. Së fundi, ata dakordësuan se harmonizimi dhe koordinimi i politikave, si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel ndërkombëtar, është parakusht për të siguruar një mjedis optimal për një ekonomi të qëndrueshme.

Guvernatori Sejko dhe përfaqësuesit e FMN-së e BB-së theksuan nevojën dhe rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të shkëlqyer midis institucioneve dhe vijimit të ofrimit të asistencës teknike në të ardhmen.

GUVERNATORI SEJKO NË NJË TAKIM ME MISIONIN E FMN-SË

18 tetor 2023, Tiranë

Më 18 tetor 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga zj. Anke Weber, shefe e Misionit për Shqipërinë. Qëllimi i vizitës së Misionit në Shqipëri është mbajtja e bisedimeve me autoritetet shqiptare në kuadër të Artikullit IV. Diskutimet u fokusuan mbi zhvillimet më të fundit ekonomike dhe financiare në vend dhe perspektivën e tyre për të ardhmen, politikën monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë me synim garantimin e stabilitetit të çmimeve, si dhe masat e marra nga institucioni që ai drejton për të ruajtur e forcuar shëndetin e sektorit bankar dhe stabilitetin financiar të vendit.

Përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar shprehën vlerësimin e tyre për politikën e drejtë monetare që ka ndjekur Banka e Shqipërisë



GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E PËRBASHKËT PËR SHTYP ME SHEFEN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTRIN E FINANCAVE DHE EKONOMISË

27 tetor 2023, Tiranë

Në datën 27 tetor 2023, Guvernatori Sejko mori pjesë në konferencën e përbashkët për shtyp me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të konsultimeve periodike mbi Artikullin IV me misionin e FMN-së në vendin tonë. Diskutimet u fokusuan në ecurinë aktuale të ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare, perspektivat e zhvillimit të tyre, si dhe politikat e duhura ekonomike dhe reformat e nevojshme strukturore që duhen zbatuar për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

dhe për kontributin e rëndësishëm të saj në stabilitetin monetar e financiar, si premisa të rëndësishme të rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë. Gjithashtu, ata vlerësuan punën e vazhdueshme mbikëqyrëse e rregullatore të Bankës së Shqipërisë dhe ndikimin e saj në treguesit pozitivë të sektorit bankar.

Guvernatori Sejko shprehu opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi çështjet në fjalë. Ai nënvizoi se ecuria pozitive e ekonomisë ka pasqyruar fleksibilitetin e sektorit privat, shëndetin financiar të tij, si dhe reagimin e duhur të politikave ekonomike. Ai shtoi se në përputhje me objektivin e Bankës së Shqipërisë, ne kemi vazhduar rrugën e një normalizimi gradual dhe të kujdesshëm



të qëndrimit të politikës monetare. Rritja graduale e normës bazë të interesit drejt nivelit të saj ekuilibër ka synuar të krijojë një mjedis financiar të përshtatshëm për kthimin e inflacionit në objektiv, brenda një horizonti kohor të arsyeshëm dhe me kosto sa më të ulëta për ekonominë.



Ai theksoi se formulimi i qëndrimit të politikës sonë monetare ka mbajtur parasysh edhe forcimin e shpejtë të kursit të këmbimit të lekut ndaj euros dhe konsolidimin fiskal të ndërmarrë nga autoritetet publike. Më tej, guvernatori shtoi se forcimi i shpejtë i lekut gjatë viti 2023 ka pasqyruar një tepriçë konstante valute në tregun e brendshëm, si pasojë e rritjes së shpejtë dhe të fortë të turizmit, investimeve të huaja direkte dhe remitançave. Ai u shpreh se ky faktor na ka mundësuar të mbajmë një nivel më të ulët të normës bazë të interesit, duke i ofruar ekonomisë shqiptare kosto më të ulëta financimi dhe duke lehtësuar barrën financiare mbi kredimarrësit.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori theksoi se prespektivat e zhvillimit të vendit mbeten pozitive. Ai shtoi se parashikimet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë viteve në vijim, ndërsa inflacioni do të kthehet në objektivin 3% gjatë vitit të ardhshëm. Ky parashikim faktorizon uljen e mëtejshme të inflacionit te partnerët tanë tregtarë dhe një ecuri më të balancuar të kërkesës dhe ofertës në ekonomi.



BANKA E SHQIPËRISË NË WORKSHOPIN E GJASHTË DEDIKUAR PLANIFIKIMIT TË NDËRHJRJES SË JASHTËZAKONSHME 30 tetor 2023, Vjenë, Austri

Më 30 tetor 2023, Zëvendësguvernatorja e Dytë Ahmetaj, shoqëruar nga Drejtoresha e Departamentit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, zj. Vasilika Kota, mori pjesë në Workshopin e gjashtë dedikuar Planifikimit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe përbushjes së kërkesave për MREL, organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Raiffeisen Bank International.

Punimet e këtij workshop-i ishin konceptuar të ndara në disa panele, ku në panelin me përfaqësues nga Bordi i Përbashkët i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në Kroaci, Çeki, Austri, Poloni dhe Rumani, zj. Kota prezantoi hapat e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë për të ngritur një regjim të suksesshëm të ndërhyrjes së jashtëzakonshme që garanton ruajtjen e stabilitetit financiar, duke qenë pararendëse e këtij procesi në Ballkan. Në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që ka transpozuar Direktivën Evropiane për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme dhe ka ndërtuar edhe kuadrin e plotë rregullativ që e shoqëron atë. Gjatë diskutimit në panel, zj. Kota prezantoi angazhimet e ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë në përmbushjen me sukses të kërkesave të reja rregullative për MREL nga sektori bankar, si dhe sfidat që paraqet përafrimi i kuadrit evropian në Shqipëri.

Në ceremoninë erastit, Zëvendësguvernatorja Ahmetaj bëri një ekspozitë të angazhimit të vazhdueshëm të sektorit bankar për kalimin me sukses të sfidave për të përmbushur kërkesat rregullative, në të njëjtin standard si grupet e mëdha bankare evropiane. Në veçanti, ajo theksoi rëndësinë e këtij angazhimi për të garantuar një sistem



bankar të shëndetshëm, të aftë të përballojë çdo goditje dhe plotësisht të përgatitur për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në mënyrë të veçantë, përfaqësuesit e BERZH-it dhe të Fondit OPEC vlerësuan arritjet e Bankës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e një regjimi profesional në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, i aftë të ruajë standardet më të mira evropiane.

FORUMI I NIVELIT TË LARTË “KLIMA, MAKROEKONOMIA DHE FINANCAT: RISQET DHE NDIKIMET QË I SHOQËROJNË”

8 nëntor 2023, Tiranë

Në datën 8 nëntor 2023, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi Forumin e Nivelit të Lartë me temë “Klima, Makroekonomia dhe Financat: Risqet dhe ndikimet që i shoqërojnë”. I organizuar nën kujdesin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, forumi u konceptua në dy sesione dhe u hap me fjalët përshëndetëse të Guvernatorit të Bankës së



Shqipërisë, z. Gent Sejko dhe Menaxherit të Zyrës së Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Emanuel Salinas.

Në fillim të fjalës së tij, Guvernatori Sejko u shpreh se ndryshimet klimatike nuk përbëjnë më një rrezik të largët, por janë realiteti ynë i tanishëm, i pasqyruar nëpërmjet ngjarjeve të paparashikuara të motit dhe probabiliteteve të rritura dhe të intensifikuara të fatkeqësive natyrore. Ai theksoi se për të vazhduar rrugën e rritjes së qëndrueshme, bankat tona duhet të identifikojnë, monitorojnë dhe menaxhojnë në mënyrë të vazhdueshme rreziqet që lidhen me klimën. Gjithashtu, sektori bankar mund të luajë një rol udhëheqës për kompanitë, jo vetëm nëpërmjet “kanalizimit të fondeve”, por edhe “edukimit të klientëve” drejt modeleve të biznesit dhe investimeve që përputhen me përgjegjësinë mjedisore. Sektori bankar duhet ta trajtojë këtë jo si një sfidë, por si një mundësi strategjike.



Më tej, Guvernatori bëri me dije se Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore kanë hartuar dhe shpallur “Strategjinë për Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të Lidhura me Klimën në Sektorin Financiar, për vitet 2023-2025”, të cilën e ka bërë publike dhe në faqen e Bankës së Shqipërisë.

Ndërkohë, Menaxheri i Zyrës së Bankës Botërore për Shqipërinë, z. Emanuel Salinas, gjatë fjalës së tij, ritheksoi faktin se sfidat





globale që lindin nga ndryshimet klimatike janë prezente dhe një aktualitet tashmë i pamohueshëm. Lidhur me këtë, Banka Botërore e vlerëson si tepër të rëndësishme përgatitjen nga ana e të gjitha institucioneve dhe më në veçanti të sektorit bankar për t'i adresuar më së miri këto sfida në mënyrë që të sigurohet jo vetëm stabiliteti dhe qëndrueshmëria afatgjatë e sektorit, por dhe mobilizimi i kapitalit drejt përshtatjes së tranzicionit të gjelbër.

Duke falenderuar Bankën e Shqipërisë për bashkëpunimin dhe përpjekjet e deritanishme në këtë drejtim, z. Salinas u shpreh se përballë një çështjeje globale si ndryshimi klimatik, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse dhe angazhim i të gjitha institucioneve në shkallë globale.

GUVERNATORI NË PREZANTIMIN E PROJEKTBUXHETIT TË VITIT 2024 NË KOMISIONIN PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

10 nëntor 2023, Tiranë

Në datën 10 nëntor 2023, Guvernatori Sejko mori pjesë në seancën e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për të dhënë opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi Projektbuxhetin e vitit 2024.

Në kuadër të aspektit makroekonomik dhe politikës fiskale, Guvernatori u shpreh se projektbuxheti i vitit 2024 merr jetë në një kontekst relativisht të favorshëm zhvillimesh ekonomike në vend. Ekonomia shqiptare është përballur me një seri sfidash gjatë katër viteve të fundit: tërmeti i vitit 2019, pandemia e viteve

2020 – 2021, si dhe pasojat ekonomike e financiare të konfliktit ushtarak në Ukrainë. Guvernatori theksoi se këto sfida kanë kërkuar një rifokusim të politikave ekonomike dhe kanë pasur një faturë relativisht të lartë financiare, e megjithatë, ekonomia shqiptare ka dëshmuar një shkallë të admirueshme rezistence, duke pasqyruar fleksibilitetin e sektorit privat, frytet e punës së vazhdueshme që kemi bërë për forcimin e stabilitetit ekonomik e financiar, si dhe suksesin e politikave kundërciklike që kemi ndjekur.



Guvernatori u shpreh se Banka e Shqipërisë gjykon se prioriteti i politikës fiskale duhet të jetë i dyfishtë: nga njëra anë, kjo politikë duhet të synojë konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit ekonomik, monetar e financiar të vendit dhe, nga ana tjetër, duhet të risë vëmendjen ndaj sfidave afatgjata të zhvillimit. Ndaj, ai theksoi se projektbuxheti i vitit 2024 ruan një balancë të mirë midis këtyre dy objektivave.

Në analizën mbi rritjen e efektivitetit dhe ruajtjen e fleksibilitetit të financave publike, Guvernatori u shpreh se këto janë dy kriteret mjaft të rëndësishme për të gjykuar mbi shkallën e përmbushjes së dy objektivave të rëndësishëm të politikës fiskale: mbështetjen e zhvillimit afatgjatë të vendit dhe aftësinë e politikës fiskale për të reaguar ndaj zhvillimeve të paparashikuara. Ai shtoi se është inkurajues fakti se financat publike shqiptare kanë pasur historikisht një balancë primare pozitive, e

cila është luhatur rreth nivelit 1.9% të PBB-së gjatë pesë viteve të fundit.

Në analizën mbi rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, Guvernatori u shpreh se projektbuxheti i vitit 2024 parashikon reduktimin e borxhit publik, nga niveli 61.5% të PBB-së i pritur për vitin 2023 në nivelin 59.8% të PBB-së për vitin 2024.



Në analizën mbi deficitet e krijuara nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, Guvernatori theksoi se vijon të jetë një sfidë serioze për financat e shtetit, sidomos në kontekstin e trendeve jo të favorshme demografike dhe të lëvizjes së lirë të forcës punëtore.

Në përfundim të fjalës së tij, lidhur me administrimin e Programeve të Partneritetit Publik – Privat, Guvernatori shprehu sugjerimet e Bankës së Shqipërisë, në interes të rritjes së efektivitetit dhe të reduktimit të rreziqeve potenciale që vijnë nga PPP.

GUVERNATORI SEJKO ME AMBASADORIN E RI TË SLLOVAKISË

10 nëntor 2023, Tiranë

Në datën 16 nëntor 2023, Guvernatori Sejko priti në një takim zyrtar kortezie në



Bankën e Shqipërisë, Ambasadorin e ri të Sllovakisë në vendin tonë, Sh.T.Z. Albin Otruba. Gjatë këtij takimi, Guvernatori Sejko i shprehu mirënjohjen Sh.T.Z. Albin Otruba për mbështetjen e deritanishme të Sllovakisë për Shqipërinë, në kuadër të procesit të integritit evropian, si dhe shprehu besimin se kjo mbështetje do të vijojë edhe në të ardhmen.

Në vijim të bisedës, Guvernatori Sejko bëri një ekspozitë të panoramës ekonomike në Shqipëri, ku theksoi se ecuria e ekonomisë gjatë vitit të fundit ka qenë pozitive, sidomos në një kontekst global sfidues, pavarësisht të cilit aktiviteti ekonomik në vend arriti të zgjerohej më tej gjatë vitit 2023. Inflacioni ka arritur të reduktohet, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm, ndërkohë që ka pasur rritje të aktivitetit turistik dhe të investimeve të huaja direkte në vend. Gjithashtu, Guvernatori u ndal edhe në qëndrimin e politikës monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë, e cila ka vijuar rrugën e një normalizimi gradual dhe

të kujdesshëm. Ai shtoi se efektet e politikës sonë monetare janë inkurajuese, duke ndihmuar kontrollin e pritjeve inflacioniste dhe funksionimin e qetë të tregjeve financiare.

Nga ana e tij, Ambasadori Otruba vlerësoi rolin e Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe garantimin e sistemit financiar në vend, sidomos në këto kohë të vështira. Në vijim, ai theksoi progresin e bërë nga Shqipëria në kuadër të procesit të integritit evropian, si dhe shprehu mbështetjen e plotë të Sllovakisë në këtë drejtim.

ZËVENDËSGUVERNATORJA E PARË MINXHOZI NË WORKSHOPIN E NIVELIT TË LARTË MBI ZHVILLIMET E SISTEMEVE TË PAGESAVE NGA BANKAT QENDRORE

16 nëntor 2023, Frankfurt, Gjermani

Më 16 nëntor 2023, Zëvendësguvernatorja e Parë Minxhozi, mori pjesë në workshopin e nivelit të lartë mbi zhvillimet e sistemeve të pagesave të organizuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) në Frankfurt, Gjermani. Punimet e workshop-it u përqendruan në



zhvillimet e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve, ku BQE-ja prezantoi se si Eurosistemi përmbush mandatin lidhur me këtë funksion, duke ndihmuar në arritjen e objektivit të përbashkët për të sjellë sistemet e pagesave të Ballkanit Perëndimor më afër standardeve të BE-së.

Zëvendësgovernatorja e Parë Minxhozi, gjatë fjalës së saj, prezantoi zhvillimet më të fundit lidhur me sistemet e pagesave në vendin tonë. Ajo theksoi se sistemet e pagesave dhe tregjet e pagesave tashmë janë të lidhura dhe të ndërthurura ngushtë me shkëmbimet ekonomike midis vendeve dhe me rritjen ekonomike të tyre. Zj. Minxhozi u shpreh se projekti rajonal për "Modernizimin e sistemit të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor" përbëhet nga një tërësi masash mbështetëse, të cilat ndihmojnë zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal dhe të Planit Ekonomik të Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Në fokus të këtyre zhvillimeve është zvogëlimi i kostove për pagesat rajonale; përgatitja e rajonit për t'u bashkuar me Zonën e vetme të Pagesave në Euro (SEPA); si dhe krijimi i një zgjidhjeje për pagesat në kohë reale brenda vendit në vendet që nuk e kanë ende një të tillë. Qëllim kryesor është gjithashtu dhe përgatitja e tyre për t'u bashkuar me TIPS, sistemin e pagesave në kohë reale SPI, që operon BQE-ja.



GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA AUTORITETI I KONKURENCËS 23 nëntor 2023, Tiranë

Në datën 23 nëntor 2023, me rastin e njëzetëvjetorit të Ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", u organizua një konferencë, ku morri pjesë dhe Guvernatori Sejko. Në fjalën e tij përshëndetëse, Guvernatori u shpreh se në këto dy dekada, Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur një politikë që i stimulon kompanitë të ofrojnë produkte dhe shërbime në termat më të favorshëm për konsumatorët, duke nxitur transparencën, eficiencën, inovacionin dhe rrjedhimisht, uljen e çmimeve në treg. Ai shtoi se një konkurrencë e drejtë dhe e shëndoshë ka një rol tepër të rëndësishëm në ekonominë e një vendi. Ajo stimulon rritjen ekonomike të vendit, duke nxitur aktivitetin tregtar, produktivitetin dhe investimet.

Më tej, Guvernatori theksoi se të njëjtat efekte, si në sektorët e tjerë të ekonomisë, konkurrenca duhet t'i prodhojë edhe në sektorin financiar, duke kontribuar në zgjerimin e gamës dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara nga bankat, si dhe rritjen e aksesit në financë.



Ai u shpreh se bankat luajnë një rol kritik për ekonominë dhe rritjen ekonomike të vendit, ndaj dhe stabiliteti financiar është një parakusht për një sistem financiar të qëndrueshëm, eficient dhe mbështetës ndaj rritjes ekonomike dhe ekonomisë reale. Guvernatori shtoi se shëndeti i sektorit bankar qëndron në zemër të një ekonomie funksionale tregu. Ai i kanalizoi kursimet e familjeve dhe bizneseve në investime dhe në financim, duke kryer kështu funksione ndërmjetësimi që janë kritike për ekonominë reale dhe kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori përgëzoi Autoritetin e Konkurrencës për arritjet dhe përballimin e sfidave të shumta në rrugëtimin e tij 20-vjeçar në mbrojtje të konkurrencës dhe të konsumatorit si dhe për kontributin në drejtim të rritjes së formalizimit të ekonomisë, duke dekurajuar konkurrencën e pandershme dhe duke incentivuar përdorimin më eficient të burimeve financiare të ekonomisë.

WORKSHOP-I XVII I KËRKIMEVE EKONOMIKE TË EVROPËS JUGLINDORE 4-5 dhjetor 2023, Tiranë

Në datat 4-5 dhjetor 2023, Banka e Shqipërisë organizoi Workshop-in XVII të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Ky workshop synoi të ofronte një forum diskutimi të punëve dhe projekteve kërkimore të kryera nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2023, si një aktivitet shkencor i kthyer tashmë në një platformë solide për shkëmbimin dhe diskutimin e punëve kërkimore në lidhje me temat e bankingut qendror. Gjatë dy ditëve të punimeve të aktivitetit u prezantuan mbi 37 materiale studimore, prej të cilave 9 materiale



kishin për autorë punonjës të Bankës së Shqipërisë.

Hapja e punimeve u përshëndet nga Guvernatori Sejko, i cili u shpreh se evolimi i agjendës së aktivitetit tonë pasqyron natyrën dinamike të sfidave me të cilat përballemi. Shoqëritë, ekonomitë dhe sistemet tona financiare janë nën presion nga burime të ndryshme: luftërat, tensionet gjeopolitike në rritje, ndryshimet demografike, përshkallëzimi i ngjarjeve ekstreme klimatike, inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi i financave e parasë. Ai shtoi se ky workshop do të shërbejë për të kuptuar më mirë origjinën dhe kompleksitetin e këtyre sfidave dhe për të hartuar politikat e duhura për trajtimin e tyre.

Më tej, Guvernatori nënvizoi se bankat qendrore duhet ende të zbulojnë si të normalizojnë politikën monetare dhe bilancet e tyre, në përputhje me pozicionet e parakrizës, pa kërcënuar rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar. Guvernatori Sejko shtoi se Banka e Shqipërisë ka ideuar dhe nisur zbatimin e dy strategjive të rëndësishme, të cilat mbështesin arritjen e objektivit kryesor të bankës, atë të stabilitetit të çmimeve dhe të objektivave të tjerë të lidhur me strategjinë e klimës dhe atë të edukimit dhe përfshirjes financiare - dhe njëkohësisht po zhvillojmë një përqasje të re me fokus digjitalizimin.

Këto iniciativa janë mbështetur dhe kanë përfituar nga kërkimet shkencore të Bankës së Shqipërisë në fushat e ndryshimeve



klimatike, edukimit dhe përfshirjes financiare të individëve dhe të sektorit privat.

të Komitetit Kombëtar të Pagesave në zbatimin e reformave strategjike për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE).

MBLEDHJA E NËNTË VJETORE E KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMIT TË PAGESAVE

13 dhjetor 2023, Tiranë

Në datën 13 dhjetor 2023, u zhvillua mbledhja e nëntë vjetore e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP) në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Mbledhja u drejtua nga zj. Luljeta Minxhozi, Kryetarja e këtij Komiteti dhe Zëvendësguvernore e Parë e Bankës së Shqipërisë. Aktiviteti u hap nga Zëvendësguvernatorja Minxhozi dhe Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë Yzeiraj, të cilët theksuan rolin e rëndësishëm

Në fjalën e saj, Zëvendësguvernatorja Minxhozi u shpreh se Banka e Shqipërisë ka nisur punën për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave, ose njohur ndryshe SEPA, që prej vitit 2021, kur u bëmë pjesë e projektit rajonal "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor".





Në vijim, zj. Minxhozi gjithashtu u ndal në punën e Bankës së Shqipërisë për implementimin e një zgjidhjeje për pagesat e shpejta (*instant payment*) të cilat janë një mundësi alternative për pagesat elektronike, ndërsa sigurojnë pagesa përgjatë 24 orëve në çdo ditë të javës me kosto më të ulëta se instrumenti alternativ, kartat.

Zëvendësguvernatorja Minxhozi theksoi gjithashtu rëndësinë e zhvillimeve infrastrukturore duke u ndalur në miratimin e rregullores "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit", e cila hyn në fuqi në janar të vitit 2024. Kjo rregullore ka për qëllim të vendosë standarde të sigurta për funksionimin e *open banking*, si dhe të garantojë sigurinë dhe konfidencialitetin e kryerjes së pagesave nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave.

Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Yzeiraj përshëndeti realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Pagesat e Vogla, të cilat kanë ndihmuar në zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë dhe në reduktimin e përdorimit të parasë fizike. Ai shprehu mbështetjen e Ministrisë për projektet e ndërrmarra nga Banka e Shqipërisë për ndryshimet rregullore që kërkohen në kuadër të anëtarësimit në SEPA, një objektiv i rëndësishëm ky i qeverisë shqiptare në axhendën e integritimit evropian. Gjithashtu, z. Yzeiraj vlerësoi gjetjen e një zgjidhjeje për pagesat e shpejta, si një instrument i cili do

të mundësojë zhvillimin e projekteve të tjera të ndërlidhura të qeverisë, si ai mbi zhvillimin e tregtisë elektronike, dixhitalizimit të plotë të fiskalizimit dhe dixhitalizimit të shërbimeve në e-Albania.

GUVERNATORI SEJKO NË MBRËMJEN E VITIT TË RI TË SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

15 dhjetor 2023, Tiranë

Në datën 15 dhjetor 2023, Guvernatori Sejko ishte i ftuar në takim të përvitshëm që organizon Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e festave të fundvitit. Në fjalën e tij përshëndetëse, Guvernatori bëri një ekspozitë të situatës ekonomike të vendit. Ai u shpreh se ekonomia shqiptare vijoi të shënojë rritje, të gjenerojë vende të reja pune dhe të përmirësojë thuajse të gjithë ekuilibrat e brendshëm e të jashtëm. Më tej, ai shtoi se sipas parashikimeve të Bankës së Shqipërisë, aktiviteti ekonomik pritet të rritet rreth nivelit 3.5%. Paralelisht me të, punësimi e pagat kanë ardhur në rritje, inflacioni është në një trend të qartë rënës, borxhi publik dhe ai i huaj janë reduktuar, bilanci i shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë ka shënuar një progres të dukshëm dhe bilancet e sektorit bankar paraqiten të shëndetshme.





Në përfundimin e fjalës së tij, Guvernatori theksoi se perspektivat e zhvillimit të vendit mbeten solide e pozitive. Ai u shpreh se parashikimet e Bankës së Shqipërisë, sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të vijojë të shënojë rritje, si në horizontin afatmesëm dhe në atë afatgjatë. Për më tepër, procesi i integritimit evropian ofron oportunitete materiale për një hap cilësor në zhvillimin ekonomik të vendit.

Së fundi, Guvernatori siguroi se Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e funksionit të saj si mbikëqyrës dhe rregullator, do të vijojë të jetë mbështetësi dhe partneri juaj, si në ditë të mira dhe në ditë të vështira, duke ofruar transparencë, bashkëpunim dhe vlerësim objektiv të kërkesave dhe propozimeve tuaja, në çdo vendimarrje.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE TË FAKULTETIT TË EKONOMISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS 16 dhjetor 2023, Tiranë

Në datën 16 dhjetor 2023, Guvernatori Sejko ishte i ftuar të merrte pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Guvernatori e nisi fjalën e tij duke theksuar se ky fakultet ka qenë dhe mbetet një nga institucionet më të rëndësishme të arsimit në vend. Ai ka prodhuar një plejadë studiuesish dhe ka furnizuar vendin me një sërë praktikantësh, të cilët kanë dhënë një kontribut të paçmuar në procesin e zhvillimit e transformimit të tij.



Në vijim, Guvernatori bëri një ekspozitë të zhvillimit ekonomik të vendit në një këndvështrim historik. Ai u shpreh se Shqipëria ka treguar një zhvillim të admirueshëm në tre dekadat e fundit. Gjatë kësaj periudhe, e ardhura për frymë në vend është rritur ndjeshëm, nga një mesatare prej rreth 600 dollarësh (amerikanë) në vitin 1990 në mbi 8.000 dollarë në vitin 2023. Për rrjedhojë, në harkun e tre dekadave, Shqipëria ka kaluar nga një vend me të ardhura të ulëta në një vend me të ardhura mesatare – të larta. Ai theksoi se ky progres ka qenë jo gjithnjë i lehtë dhe shpesh i mundimshëm, duke kërkuar



një ndryshim radikal të sistemit ekonomik, nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë.



Duke qënë se tema e konferencës trajtonte turizmin, Guvernatori theksoi se një nga historitë e suksesit të ekonomisë shqiptare gjatë viteve të fundit ka qenë zhvillimi i sektorit të turizmit. Ai shtoi se flukset hyrëse turistike janë zgjeruar nga 1.2 miliardë euro në vitin 2010 në 2.8 miliardë euro në vitin 2022 dhe janë në rrugë të mbarë për të arritur 4 miliardë euro në vitin 2023. Ky rrugëtim është pasqyruar në një përmirësim gradual dhe të vazhdueshëm të bilancit të shkëmbimeve korrente të vendit, bilanc i cili u përmirësua nga nivele dyshifrore deficiti në fillim të dekadës paraardhëse në një suficit gjatë tremujorëve të parë të vitit 2023.



GUVERNATORI SEJKO ME GAZETARË, ANALISTË DHE DREJTUES TË MEDIAS GJATË AKTIVITETIT “ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2023”

18 dhjetor 2023, Tiranë

Në datën 18 dhjetor 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë të njohur, analistë, gazetarë të njohur dhe përfaqësues të shtypit të shkruar e medias elektronike në Shqipëri. Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të Guvernatorit, i cili fillimisht falënderoi përfaqësuesit e medias për pjesëmarrjen e tyre, si dhe për pasqyrimin me realizëm dhe vërtetësi të gjithë aktivitetit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2023, përfshirë dhe vendimmarrjen e saj në fushën e politikës monetare. Më tej, Guvernatori theksoi se Banka e Shqipërisë në vazhdimësi do të jetë një partner luajal i botës mediatike duke garantuar një komunikim transparent dhe të shpejtë, të stilizuar në një gjuhë të thjeshtë, lehtësisht të perceptueshme nga ana e publikut të gjerë.



Në vijim të këtij aktiviteti, siç është traditë, u ndanë edhe tre çmimet e konkursit të hapur “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2023”. Ky konkurs



organizohet prej 17 vjetësh nga Banka e Shqipërisë dhe vlerëson çdo vit tre temat më të mira të përgatitura nga studentë shqiptarë

të diplomuar brenda dhe jashtë vendit në fushën e ekonomisë dhe financës. Për vitin 2023, temat fokusoheshin te problemet reale të ekonomisë dhe financës, si dhe përdornin metoda bashkëkohore gjithnjë e më të sofistikuara për të bërë vlerësimin e hipotezave dhe analizën e të dhënave ekonomike e financiare.

TË TJERA

“NETËT E MUZEUT”, TETOR DHE NËNTOR 2023

Në datat 26 tetor dhe 2 nëntor 2023, në kuadër të ciklit të “Netëve të Muzeut”, Muzeu i Bankës së Shqipërisë organizoi dy ekspozita me fokus prezantimin e zhvillimit ekonomik

dhe marrëdhënieve tregtare me vendet fqinje të qyteteve të Beratit dhe Shkodrës, në shek. XVII - XIX.

Ndryshe nga tradita e deritanishme, këto dy “Netë Muzeu” të organizuara në bashkëpunim me Qendrën Muzeore Berat dhe Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sporteve të Bashkisë Shkodër, sollën për publikun dy ekspozita me fotografi ilustruese të periudhës, si dhe u shoqëruan me kumtesa historike, në formatin e “Muzeut në një valixhe”.



BANKA E SHQIPËRISË I KOMUNIKON PUBLIKUT VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori i komunikon publikut vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë lidhur me politikën monetare, në një konferencë për shtyp. Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, janë zhvilluar pesë konferenca të tilla për shtyp, përkatësisht më: 5 korrik, 2 gusht, 4 tetor, 1 nëntor, 20 dhjetor.



Në këto konferenca, Guvernatori Sejko i komunikon publikut të gjerë vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë lidhur me ndryshimet e normës bazë të interesit, e cila u rrit nga niveli 3.0% në 3.25% në muajin nëntor 2023 dhe mbeti e pandryshuar deri në fundin e vitit 2023. Ndërsa, norma e interesit të depozitës njëditore u rrit nga 2.00% në 2.25% dhe ajo e normës së interesit



të kredisë njëditore nga 4.00% në 4.25%, si dhe mbetën të pandryshuara deri në fund të vitit 2023.

PREZANTIMET PËR MEDIAN TË RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si pjesë e strategjisë së saj të komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë organizon prezantimin e raporteve të saj periodike për median, përpara publikimit të tyre. Bazuar në kalendarin e publikimit të raporteve periodike të publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, në fillim të vitit 2023, gjatë 6-mujorit të dytë të këtij viti, janë zhvilluar 4 prezantime "off the records" për mediat:



1. Prezantimi i Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes për vitin 2022, në datën 14 korrik 2023;
2. Prezantimi i Raportit të Politikës Monetare III/2023, në datën 10 gusht 2023;

3. Prezentimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6-mujori I 2023, në datën 5 tetor 2023;
4. Prezentimi i Raportit të Politikës Monetare IV/2023, në datën 9 nëntor 2023.

Këto takime organizohen ditën e publikimit të raporteve përkatëse në faqen e internetit. Ato synojnë orientimin e medias në leximin e drejtë të vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë dhe vlerësohen si një mjet mjaft efikas komunikimi.

SEMINARET E TË PREMTES

Banka e Shqipërisë organizon rregullisht aktivitetin me natyrë kërkimore "Seminari i të Premtes". Kjo nismë fton punonjësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë u prezantuan dy punime: një nga Banka e Shqipërisë dhe një nga Universiteti i Oxfordit. Punimi i parë me temë "*In (Re)Search of Credit Crunch (Rationing) Periods in Albania: A Disequilibrium Approach*" u prezantua nga z. Gerti Shijaku, në datë 10 nëntor 2023. Prezentimi i dytë me temë "Sfidat e stabilitetit financiar dhe politikës monetare në epokën post-pandemike" u prezantua nga Prof. Dimitrios Tsomocos, Profesor i Ekonomisë Financiare në Universitetin e Oxfordit, SAïD Business School dhe fellow in Management në St. Edmund Hall, në datën 21 shtator 2023.

PËRFUNDIMI I AFATIT PËRFUNDIMTAR TË KËMBIMIT TË DISA KARTËMONEDHAVE PA KURS LIGJOR

Gjatë 6-mujorit të dytë të vitit 2023, Banka e Shqipërisë solli sërish në vëmendje të publikut se bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë 17/2013 "Për shtyrjen e afatit të këmbimit të disa kartëmonedhave pa kurs ligjor", data 31 dhjetor 2023 ishte afati i fundit për këmbimin e disa kartëmonedhave pa kurs ligjor.



Kartëmonedhat, të cilave u përfundoi afati, ishin:

- 100 Lekë, emetim i viteve 1993, 1994, 1996, imazhi i Luftëtarit Kombëtar;
- 100 Lekë, emetim i vitit 1996, imazhi i Fan S. Nolit;
- 200 Lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996, imazhi i Ismail Qemalit;
- 500 Lekë, emetim i viteve 1991, 1992, 1993, 1996, 1997, imazhi i vajzës me lule dielli;
- 500 Lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1996, imazhi i Naim Frashërit; dhe
- 1000 Lekë, emetim i viteve 1992, 1994, 1995, 1996, imazhi i Skënderbeut.

PJESËMARRJA E STAFIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NË MARATONËN E TIRANËS

Me motivin për të sfiduar veten dhe për të promovuar një mënyrë të shëndetshme jetese, punonjësit e Bankës së Shqipërisë iu bashkuan për herë të parë edicionit të shtatë të Maratonës së Tiranës 2023, eventit më të madh sportiv në vend.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet mbështeste fushatën e Bankës së Shqipërisë "As i vjetër, as i ri, jam thjesht Lek" për ndërgjegjësimin e publikut për mospërdorimin e termave të gabuar "lek i ri" dhe "lek i vjetër" në veprimet e tyre financiare, terminologji që ka sjellë në kohë një konfuzion të vazhdueshëm.

Duke përfitur nga rasti, i bëjmë thirrje qytetarëve ta lexojnë vlerën siç shkruhet në kartëmonedhë.



AKTIVITETE SOCIALE TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Në datën 21 dhjetor 2023, punonjësit e Bankës së Shqipërisë blenë kartolina urimi për festat e fundvitit me vizatime të fëmijëve, në kuadër të një aktiviteti humanitar të organizuar nga fshati "SOS" dhe Fondacioni "Down Syndrome Albania". Fondet e mbledhura nga shitja e tyre shkuan në ndihmë të fëmijëve të fshatit "SOS" dhe për të siguruar terapi pa pagesë të fondacionit "Down Syndrome Albania".

